

Dokument Politik

**Fuqizimi i Këshillave Rinorë Vendorë
në Shqipëri**

**Rritja e Pjesëmarrjes së të Rinjve
në Vendimmarrje**

TABELA E PERMBAJTJES

Parathënie	3
1. Hyrje: Pjesëmarrja Rinore dhe Sfidat Aktuale në Shqipëri	4
2. Korniza Ligjore për Pjesëmarrjen Rinore në Shqipëri: Ligji Nr. 75/2019 dhe Strukturat Përfaqësuese	6
2.1 Strukturat e Përcaktuara nga Ligji: Nga NIVELI Lokal te Niveli Qendror	7
2.2 Funksionaliteti i Pritshëm i Strukturave	8
2.3 Roli i Bashkive dhe Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe fëmijët	8
2.4 Rruga nga Ligji në Politikë Publike: Sfidat në Zbatim	9
3. Nga Korniza Ligjore te Praktika: Nevoja për Forcimin e Zbatimit të Strukturave Rinore	10
4. Pse Tani është Koha Vendimtare për të Vepruar?	11
5. Rekomandime për Aktivizimin dhe Qëndrueshmërinë e Strukturave Rinore në Shqipëri	12
<i>Zëri nga Strukturat Rinore Lokale: Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen</i>	13
6. Përmbyllje: Strukturat Rinore si Bazë për Pjesëmarrje Demokratike dhe Legjitimitet Politik	14

Lista e shkurtimeve:

Shkurtimi	Termi i plotë
AKR	Agjencia Kombëtare për Rininë
KKR	Këshilli Kombëtar Rinor
KVR	Këshilli Vendor Rinor
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
YPI	Indeksi i Pjesëmarrjes së të Rinjve (Youth Participation Index)
YHWBT	Youth Hub for the Western Balkans and Turkey
SKR	Strategjia Kombëtare për Rininë
BE	Bashkimi Evropian
INSTAT	Instituti I Statistikave

PARATHËNIE

Ky dokument politik është përgatitur në kuadër të projektit rajonal “Zëra më të Fortë për Zgjedhje më të Mira - Youth Hub për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë (YHWBT)”, me synimin për të adresuar sfidat kryesore që lidhen me pjesëmarrjen politike të të rinjve në Shqipëri.

Dokumenti mbështetet në gjetjet e Indeksit të Pjesëmarrjes Rinore në Shqipëri 2023, i zhvilluar nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, në bashkëpunim me aktorë lokalë dhe kombëtarë. Ky indeks ofron një pasqyrë të thelluar mbi gjendjen aktuale të pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendimmarrëse, duke evidentuar boshllëqet kryesore dhe duke ofruar rekomandime strategjike për përmirësimin e saj në mënyrë të qëndrueshme dhe të strukturuar.

Bazuar në këto gjetje, ky dokument fokusohet në një prej rekomandimeve kyçe të dimensionit të pjesëmarrjes politike: aktivizimin dhe funksionalizimin e strukturave përfaqësuese rinore, në veçanti Këshillat Vendorë Rinorë (KVR), me qëllim forcimin e ndikimit të të rinjve në vendimmarrje, në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar.

Për të përforcuar përmbajtjen dhe për të orientuar rekomandimet, në mars 2025 u zhvillua një takim konsultativ gjithëpërfshirës, me pjesëmarrjen e 20 përfaqësuesve nga organizatat e shoqërisë civile, strukturat rinore lokale, bashkitë, sektori privat dhe institucionet publike.

Agjencia Kombëtare për Rininë (AKR) dhe INSTAT morën pjesë si partnerë mbështetës të projektit, duke kontribuar në lidhjen e analizës me realitetin institucional dhe të dhënat statistikore të përditësuara.

Gjithashtu, për të përfshirë drejtpërdrejt zërin e të rinjve në nivel vendor, u shpërnda një pyetësor i shkurtër në katër KVR: Shkodër, Malësi e Madhe, Sarandë dhe Has si dhe u morrën të dhëna nga projekti Zë dhe impact që Përtej Barrierave po zhvillon me KVR në Sarandë, Gjirokastrë, Tepelenë dhe Ersekë. Përgjigjet e tyre ndihmuan në verifikimin e sfidave të trajtuara në këtë dokument dhe ofruan perspektiva konkrete për përmirësime të zbatueshme në terren.

Ky dokument i drejtohet vendimmarrësve në nivel vendor dhe kombëtar, institucioneve përgjegjëse, aktorëve të shoqërisë civile si dhe të gjithë atyre që janë të angazhuar në forcimin e pjesëmarrjes rinore dhe përmirësimin e qeverisjes vendore. Qëllimi është të kontribuojë në përmirësimin e politikave rinore dhe krijimin e një mjedisi ku strukturat rinore të jenë aktive, përfaqësuese dhe me ndikim pozitiv në zhvillimet demokratike të vendit.

1. HYRJE: PJESËMARRJA RINORE DHE SFIDAT AKTUALE NË SHQIPËRI

Pjesëmarrja kuptimplotë e të rinjve në vendimmarrje është një element thelbësor për funksionimin e një sistemi demokratik të drejtë, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm. Në Shqipëri, megjithëse është krijuar një kornizë ligjore që nxit përfshirjen e të rinjve në jetën publike dhe institucionale, pjesëmarrja e tyre reale mbetet e kufizuar, e fragmentuar dhe shpesh formale. Kjo mospërputhje mes vullnetit ligjor dhe realitetit të zbatimit vazhdon të jetë një nga sfidat më të mëdha të politikës rinore në vend.

Sipas **Indeksit të Pjesëmarrjes Rinore për Shqipërinë 2023¹¹**, Shqipëria ka bërë përparim në ngritjen e strukturave rinore si pjesë e reformës institucionale, por përfaqësimi i të rinjve në pozicione lidërshepi dhe ndikimi i tyre në vendimmarrje mbetet minimal. Vetëm 1.4% e deputetëve në Kuvend i përkasin moshës 15–29 vjeç, dhe në vitin 2023 nuk u regjistrua asnjë ministër, zëvendësministër apo kryetar bashkie nga kjo grupmoshë. Kjo mungesë përfaqësimi e dobëson legjitimitetin e sistemit përballë brezit të ri, duke thelluar hendekun ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve të rinj.

INDIKATORËT	GJITHSEJ	FEMËR	MASHKULL	VITI
Ministra të Rinj në Qeveri	0%	0%	0%	2023 ¹
Zëvendësministra të Rinj në Qeveri	0%	0%	0%	2023 ¹
Deputetë të Rinj në Parlament	1.40%	0.70%	0.70%	2023 ¹
Kryebashkiakë të Rinj	0%	0%	0%	2023 ¹
Mjetet Online për Informim dhe Pjesëmarrje në Vendimmarrje të Qeverisë dhe Parlamentit	92%	Jo e Aplikueshme		2023 ¹
Mjetet Online për Informim dhe Pjesëmarrje në Vendimmarrje të Bashkive	95%			2023 ¹
Ekzistenca e Strukturave Rinore (këshillat/parlamentet/bordet) në nivel kombëtar	PO			2023 ¹
Ekzistenca e Strukturave Rinore (këshillat/parlamentet/sindikatat) në nivel lokal	98%			2023 ¹
Të Rinj të Punësuar në Administratën Publike në Nivel Qendror	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	2023 ²
Të Rinj të Punësuar në Administratën Publike në Nivel Lokal	10.5%	14.7%	8%	2023 ³
Të Rinj në Pozicione Drejtuese dhe Vendimmarrëse në Administratën Publike në Nivel Qendror	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	2023 ²
Të Rinj në Pozicione Drejtuese dhe Vendimmarrëse në Administratën Publike në Nivel Lokal	6.10%	6.20%	6%	2023 ³
% e Buxhetit të Bashkive Dedikuar Rinisë	2-3%	Jo e Aplikueshme		2023 ³

Tabela 1. Të dhëna mbi Pjesëmarrjen Politike të të Rinjve

Për më tepër, edhe pse shumica e bashkive kanë themeluar **Këshilla Vendorë Rinorë (KVR)** në përputhje me Ligjin Nr. 75/2019 “Për Rininë”, në shumë raste këto struktura funksionojnë pa plan pune, pa mbështetje të qëndrueshme financiare dhe pa lidhje të qarta me procesin e politikëbërjes në nivel lokal. Të dhënat e mbledhura tregojnë se shpesh mungon përfaqësimi i barabartë, diversiteti dhe rotacioni, duke e kthyer

¹ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. (2023, Dhjetor 18). *Raporti kombëtar mbi pjesëmarrjen politike, sociale dhe ekonomike të të rinjve 2023*. Beyond Barriers. <https://beyondbarriers.org/2024/12/20/raporti-kombetar-i-monitorimit-te-pjesemarrjes-politike-sociale-dhe-ekonomike-te-te-rinjve/>

pjesëmarrjen në një proces të mbyllur, ku përfshihen vetëm grupe të caktuara ose individë me qasje të privilegjuar².

Sfidat thelbësore të pjesëmarrjes rinore në Shqipëri nuk kufizohen në mungesën e hapësirës institucionale, por lidhen ngushtësisht me **mospërputhjen ndërmjet përfaqësimit formal dhe ndikimit real**. Aktivizmi i të rinjve është shpesh i pranishëm në forma komunitare, joformale apo të lidhura me nisma të shoqërisë civile, por ai nuk përkthehet në ndikim të drejtpërdrejtë në hartimin apo mbikëqyrjen e politikave publike. Ky hendek e rrezikon funksionin e strukturave rinore si ura lidhëse mes komunitetit dhe pushtetit lokal.

Në një pjesë të konsiderueshme të territorit, përfshirja e të rinjve vazhdon të varet nga projekte të përkohshme, mbështetje të donatorëve apo nisma të izoluar, duke reflektuar mungesë të qëndrueshmërisë dhe koordinimit institucional. Kjo situatë është veçanërisht e evidente në bashkitë më të vogla dhe në zonat rurale, ku kapacitetet për menaxhimin e strukturave rinore janë më të kufizuara, ndërsa qasja në informacion dhe pjesëmarrje është më e pabarabartë.

Në këtë kontekst, përforsimi i mekanizmave ekzistues nuk është një çështje vetëm e mirëqeverisjes lokale, por një kërkesë politike që lidhet me vetë natyrën e demokracisë përfaqësuese. Të rinjtë nuk mund të jenë vetëm objekt politikash, ata duhet të jenë bashkautorë të tyre. Funksionalizimi i strukturave rinore, si dhe integrimi i tyre në ciklin e plotë të vendimmarrjes, është një domosdoshmëri për garantimin e përfaqësimit real dhe për të ndërtuar një marrëdhënie të qëndrueshme besimi midis brezit të ri dhe institucioneve.

2. KORNIZA LIGJORE PËR PJESËMARRJEN RINORE NË SHQIPËRI: LIGJI NR. 75/2019 DHE STRUKTURAT PËRFAQËSUESE

Në vitin 2019, Shqipëria ndërmori një hap të rëndësishëm drejt institucionalizimit të pjesëmarrjes rinore në proceset vendimmarrëse përmes miratimit të Ligjit Nr. 75/2019 "Për Rininë". Ky ligj shënoi themelimin e një kuadri ligjor dhe institucional të dedikuar për të rinjtë, me qëllimin për të rritur përfshirjen e tyre aktive në jetën publike, për të nxitur zhvillimin personal dhe profesional, si dhe për të forcuar kapacitetet e tyre qytetare.²

Ligji bazohet në disa parime themelore si: pjesëmarrja aktive, gjithëpërfshirja, mosdiskriminimi, barazia gjinore, partneriteti ndër-institucional dhe zhvillimi i qëndrueshëm. Në thelb të tij qëndron ideja se të rinjtë nuk janë thjesht përfitues të politikave publike, por aktorë të barabartë dhe të domosdoshëm në vendimmarrje, të cilët duhet të jenë të përfshirë në mënyrë strukturore në çdo proces që ndikon drejtpërdrejt në jetën dhe të ardhmen e tyre.

Në mars të vitit 2025, ligji u amendua me synimin për të thelluar më tej rolin e të rinjve në zhvillimin politik, social dhe ekonomik të vendit. Ndryshimet e fundit synojnë gjithashtu ndërtimin e një infrastrukture institucionale më të qëndrueshme dhe më mbështetëse për të rinjtë, përmes mekanizmave konkretë të përfshirjes dhe fuqizimit të tyre në nivel vendor dhe kombëtar³. Ky moment përfaqëson një fazë të rëndësishme zhvillimi, pasi rinia, në një shkallë globale, është vendosur në qendër të politikave zhvillimore.

² Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. (2019, November 4). *Ligji Nr. 75/2019 për rininë*. <https://riniafemijet.gov.al/wp-content/uploads/2022/07/Ligji-Nr.75.Date-4.11.2019-Per-Rinine.pdf>

³ Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. (2025, March 17). *Projekligji për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin "Për Rininë" në Kuvend. Muzhaqi: "I harmonizuar me standardet e BE-së"*. <https://riniafemijet.gov.al/en/projekligji-per-disa-shtesa-dhe-ndryshime-ne-ligjin-per-rinine-ne-kuvend-muzhaqi-ligji-per-rinine-i-harmonizuar-me-standardet-e-be-se/>

Në Shqipëri, ngritja e një ministrie të posaçme për çështjet e rinisë është një hap domethënës që tregon vullnetin politik për të prodhuar ndryshime reale dhe për të përmirësuar gjendjen e të rinjve në vend.

Në këtë kuadër, AKR dhe Ministria e Shtetit për Rininë dhe fëmijët, janë aktualisht të angazhuara në procesin e hapjes, rikonstruktimit dhe fuqizimit të qendrave rinore në nivel vendor. Këto qendra synojnë të krijojnë hapësira të dedikuara për zhvillim personal, edukim jo-formal dhe bashkëpunim komunitar, ku të rinjtë të kenë mundësi të shprehen, të angazhohen dhe të ndërmarrin nisma me ndikim social dhe institucional. Këto investime përfaqësojnë më shumë sesa përmirësim infrastrukturor, ato janë instrumente për ndërtimin e një kulture aktive rinore dhe forcimin e marrëdhënies midis të rinjve dhe shtetit.

2.1 STRUKTURAT E PËRCAKTUARA NGA LIGJI: NGA NIVELI LOKAL TE NIVELI QENDROR

Ligji përcakton qartë ndërtimin e strukturave përfaqësuese rinore në dy nivele: vendor dhe kombëtar.

⇒ **Këshillat Vendorë Rinorë (KVR):**

Të parashikuar në nenin 7 të ligjit, KVR-të janë struktura konsultative që krijohen nga bashkitë për të garantuar pjesëmarrjen e të rinjve në hartimin dhe monitorimin e politikave vendore për rininë. Ato duhet të jenë përfaqësuese të spektrit të gjerë të rinisë, përfshirë individë, organizata rinore, grupime joformale, përfaqësues nga shkollat dhe aktorë të komunitetit lokal.

⇒ **Këshilli Kombëtar Rinor (KKR):**

Sipas nenit 8, ky këshill ka rol këshillimor pranë Ministrisë së shtetit përgjegjëse për rininë dhe fëmijët dhe synon të ndërmjetësojë interesat e të rinjve në nivel qendror. Përbërja e tij duhet të pasqyrojë përfaqësues të organizatave rinore, përfaqësues të strukturave vendore dhe institucioneve publike, me një rol kyç në zhvillimin dhe ndjekjen e Strategjisë Kombëtare për Rininë.

Ligji parashikon gjithashtu ngritjen e Qendrave Rinore në nivel lokal si hapësira për zhvillim, aktivizëm dhe ndërveprim qytetar mes të rinjve dhe institucioneve. Në mënyrë komplementare, ai u ngarkon bashkive përgjegjësinë për hartimin e Planeve Vendore për Rininë, si dokumente strategjike të miratuara nga këshillat bashkiakë, me pjesëmarrjen e strukturave rinore përkatëse

2.2 FUNKSIONALITETI I PRITSHËM I STRUKTURAVE

Ligji nuk kufizohet vetëm në krijimin e strukturave, por kërkon që ato të kenë rol proaktiv dhe funksional në çdo fazë të ciklit të politikëbërjes: konsultim, hartim, zbatim dhe monitorim të politikave publike që prekin të rinjtë. Po ashtu, thekson parimin e pjesëmarrjes jo-formale, duke përfshirë edhe të rinjtë jashtë strukturave të organizuara. Qasja e Ligjit për Rininë është në përputhje me dokumentet Evropiane për pjesëmarrjen rinore, përfshirë Rezolutën e Këshillit të Europës për përfshirjen e të rinjve në jetën demokratike, si dhe me kërkesat e kapitullit 23 dhe 24 të *acquis communautaire* për vendet që synojnë anëtarësimin në BE.

2.3 ROLI I BASHKIVE DHE MINISTRISË SË SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

Ligji Nr. 75/2019 përcakton ndarjen e përgjegjësi ndërmjet pushtetit vendor dhe qendror në funksion të garantimit të pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje. Në këtë arkitekturë institucionale, bashkitë luajnë një rol kyç si përgjegjëse për krijimin, funksionimin dhe mbështetjen e strukturave rinore në nivel lokal.

Më konkretisht, bashkitë janë të detyruara të krijojnë KVR, t'u sigurojnë atyre mbështetje teknike dhe financiare, dhe të garantojnë pjesëmarrjen e tyre në procesin e hartimit dhe zbatimit të politikave publike vendore. Përtej krijimit formal, ligji i ngarkon bashkive përgjegjësinë për t'i përfshirë këto struktura në mënyrë të vazhdueshme dhe të kuptimshme në ciklin e politikëbërjes. Kjo përfshin, ndër të tjera, përfshirjen në hartimin e Planeve Vendore për Rininë, në mbikëqyrjen e zbatimit të tyre, si dhe në monitorimin e shërbimeve dhe nismave për të rinjtë.

Nga ana tjetër, ministria përgjegjëse për rininë dhe fëmijët ka mandatin për të siguruar koordinimin kombëtar të politikave rinore. Ajo është përgjegjëse për hartimin dhe ndjekjen e Strategjisë Kombëtare për Rininë, për lehtësimin e funksionimit të KKR, si dhe për monitorimin e zbatimit të ligjit dhe akteve nënligjore që burojnë prej tij. Roli i ministrisë së shtetit për rininë dhe fëmijët nuk është thjesht politik, por edhe operacional, pasi ajo duhet të veprojë si një nyje lidhëse ndërmjet strukturave vendore, agjencive të tjera publike dhe vetë të rinjve.

Nëse kjo arkitekturë funksionon sipas parashikimeve ligjore, pjesëmarrja rinore mund të strukturohet në disa nivele dhe të decentralizuar, duke mundësuar që zëri i të rinjve të artikullohet në mënyrë efektive nga komuniteti lokal deri në nivelin kombëtar të vendimmarrjes. Kjo kërkon jo vetëm përmbushjen formale të detyrimeve institucionale, por edhe një kulturë të bashkëpunimit ndërinstitutional dhe angazhimi të qëndrueshëm politik, që garanton se pjesëmarrja nuk mbetet simbolike, por bëhet reale dhe me ndikim të matshëm

2.4 RRUGA NGA LIGJI NË POLITIKË PUBLIKE: SFIDAT NË ZBATIM

Ligji Nr. 75/2019 ka krijuar një bazë të rëndësishme për institucionalizimin e pjesëmarrjes rinore, duke ofruar një kornizë të qartë ligjore dhe një arkitekturë funksionale që, në teori, mundëson përfshirjen në disa nivele të rinjve në proceset vendimmarrëse. Megjithatë, në praktikë, zbatimi i ligjit mbetet i fragmentuar, shpesh formal dhe i varur nga konteksti lokal, kapacitetet institucionale dhe vullneti politik.

Një nga sfidat më të mëdha është mungesa e standardizimit operacional. Ligji nuk përcakton mekanizma të detajuar për mënyrën e funksionimit të KVR-ve dhe KKR-së, për përzgjedhjen e anëtarëve, organizimin e mbledhjeve, raportimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të tyre. Kjo ka çuar në praktika të ndryshme midis bashkive, duke prodhuar një mospërputhje të madhe në cilësinë dhe funksionalitetin e strukturave rinore, si dhe një mungesë transparence në përfaqësim.

Po ashtu, nuk ekziston një sistem i unifikuar monitorimi dhe vlerësimi, i cili të mundësojë ndjekjen e performancës së KVR-ve apo të vetë zbatimit të PLVR-ve. Kjo e pamundëson matjen e impaktit real që këto struktura kanë në vendimmarrjen lokale dhe në përmirësimin e politikave publike për të rinjtë. Mungesa e indikatorëve të qartë, të krahasueshëm dhe të raportueshëm në nivel kombëtar lë një boshllëk të konsiderueshëm në llogaridhënie dhe përmirësim të vazhdueshëm.

Për më tepër, ligji nuk parashikon mekanizma të qarta llogaridhënieje institucionale për strukturat përfaqësuese. Mungesa e detyrimit për të publikuar raporte të rregullta vjetore, për të zhvilluar konsultime me të rinjtë në mënyrë të hapur dhe të dokumentuar, apo për të bërë transparente procedurat e përzgjedhjes dhe rotacionit, e bën procesin e pjesëmarrjes të cenueshëm dhe jo gjithmonë legjitim në perceptimin e të rinjve.

Një tjetër faktor kritik është mungesa e mbështetjes së qëndrueshme financiare dhe teknike, veçanërisht në nivel vendor. KVR-të në shumë bashki operojnë pa buxhet të dedikuar, pa staf të trajnuar dhe pa koordinim të qëndrueshëm me sektorët e tjerë bashkiakë. Kjo ndikon drejtpërdrejt në aftësinë e tyre për të qenë aktive, për të organizuar aktivitete, për të kontribuar në plane strategjike apo për të vepruar si një zë real i komunitetit rinor.

Së fundi, mungesa e një platforme kombëtare për shkëmbimin e praktikave të mira, për rrjetëzimin ndërstrukturor dhe për bashkëpunim ndërinstitucional, e dobëson koherencën e politikave rinore dhe zvogëlon impaktin që KVR dhe KKR mund të kenë në zhvillimin e politikave të përbashkëta, të matshme dhe gjithëpërfshirëse. Këto sfida, nëse nuk adresohen në mënyrë të strukturuar dhe të koordinuar, rrezikojnë që pjesëmarrja rinore të mbetet e kufizuar në nivel simbolik. Ligji për Rininë, ndonëse progresiv në përmbajtje, ka nevojë të mbështetet nga instrumente konkrete të zbatimit, si udhëzime të detajuara, trajnime për administratën lokale, financim i qëndrueshëm për strukturat dhe mekanizma të qartë për matjen dhe vlerësimin e progresit.

Për ta kthyer ligjin nga një akt normativ në një mjet funksional për përfshirje efektive rinore, është e nevojshme një qasje e re që ndërthur standardizimin, financimin, transparencën dhe koordinimin institucional, duke përfshirë vetë të rinjtë në çdo hap të këtij procesi.

3. NGA KORNIZA LIGJORE TE PRAKTIKA: NEVOJA PËR FORCIMIN E ZBATIMIT TË STRUKTURAVE RINORE

Krijimi i një kornize ligjore për pjesëmarrjen rinore në Shqipëri përbën një hap të rëndësishëm drejt institucionalizimit të rolit të rinjve në proceset vendimmarrëse. Megjithatë, zbatimi i kësaj kornize ka qenë i pabarabartë dhe shpesh i kufizuar në veprime formale, që nuk janë shoqëruar me funksionalitet të qëndrueshëm. Struktura si KVR-të dhe KKR-ja ekzistojnë në të gjitha bashkitë dhe në nivel kombëtar, por nuk janë të pajisura me burimet, përkufizimet dhe mjetet e nevojshme për të ushtruar realisht funksionin që u ngarkon ligji.

Një nga mangësitë më të dukshme është mungesa e qartësisë rreth rolit të këtyre strukturave në ciklin e politikëbërjes. Ligji i njeh si struktura konsultative, por në praktikë, pjesëmarrja e tyre në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave mbetet sipërfaqësore, shpeshherë e bazuar në ftesa të paformalizuara ose procese jo të standardizuara. Kjo ka krijuar një hendek ndërmjet aspiratës ligjore për përfshirje dhe realitetit të veprimit të kufizuar institucional.

Një tjetër problematikë kritike është mungesa e mekanizmave të institucionalizuar të bashkëpunimit ndërmjet KVR-ve dhe njësive administrative të bashkive. Në shumicën e rasteve, këto struktura nuk kanë akses të drejtpërdrejtë në informacion, nuk janë përfshirë në buxhetimin e politikave rinore dhe nuk ekziston një sistem formal për ndjekjen e rekomandimeve që ato prodhojnë. Kjo e kthen pjesëmarrjen në një proces simbolik, që perceptohet më shumë si procedurë formale se sa si një kanal real ndikimi politik.

Për më tepër, mbështetja institucionale dhe financiare për strukturat rinore është e paqëndrueshme dhe shpesh e varur nga projekte afatshkurtra ose nga prioritetet e përkohshme të qeverisjes vendore. Kjo situatë është edhe më e theksuar në bashkitë e vogla dhe në zonat rurale, ku mungojnë jo vetëm burimet financiare, por edhe kapacitetet njerëzore dhe infrastruktura e nevojshme për mbështetjen e aktivizmit rinor. Në këto raste, KVR-të ekzistojnë vetëm në emër, ndërkohë që nuk zhvillojnë veprimtari, nuk kanë platformë komunikimi me të rinjtë dhe nuk ushtrojnë funksione të dukshme.

Mungesa e një qasjeje të standardizuar, e kombinuar me fragmentarizimin e zbatimit dhe mungesën e koordinimit ndër-institucional, ka krijuar një klimë të paqartë funksionale për pjesëmarrjen rinore në nivel lokal dhe kombëtar. Kjo jo vetëm që e ul efektivitetin e strukturave ekzistuese, por krijon edhe zhgënjim dhe apati tek të rinjtë, të cilët nuk arrijnë të shohin rezultate të prekshme nga përfshirja e tyre.

Për ta kthyer këtë kornizë ligjore në një mekanizëm real të ndikimit politik dhe përfaqësimit rinor, është e domosdoshme të forcohet zbatimi në nivel praktik, përmes qartësisë të mandateve, sigurimit të mbështetjes së qëndrueshme dhe krijimit të mekanizmave të matshëm të monitorimit dhe llogaridhënies. Këto hapa nuk janë vetëm çështje administrative, ato janë thelbësore për të garantuar që pjesëmarrja e të rinjve të mos mbetet vetëm aspiratë ligjore, por të bëhet pjesë e qëndrueshme e kulturës demokratike në vend.

4. PSE TANI ËSHTË KOHA VENDIMTARE PËR TË VEPRUAR?

Në një moment kur Shqipëria synon të forcojë institucionet demokratike dhe të përshpejtojë procesin e integritetit evropian, funksionalizimi i mekanizmave të përfaqësimit rinor nuk përbën më një alternativë, por një domosdoshmëri politike dhe institucionale. Nevojitet një qasje e qartë dhe proaktive për të kaluar nga pjesëmarrja formale, në një angazhim real e ndikues të rinjve në hartimin dhe zbatimin e politikave publike. Sot vendi ndodhet përpara një pike kthese ku duhet të vendosë nëse strukturat rinore do të mbeten si instrumente simbolike në letër, apo do të shndërrohen në mekanizma të gjallë të demokracisë përfaqësuese në nivel lokal dhe kombëtar.

Ligji Nr. 75/2019 ekziston dhe strukturat përfaqësuese janë ngritur në të gjitha 61 bashkitë e vendit. Megjithatë, zbatimi i tyre është ende i fragmentuar dhe shpeshherë i varur nga vullneti dhe prioritetet e drejtuesve vendorë, pa standarde të unifikuara për funksionim, përbërje dhe ndërveprim institucional. Nëse nuk merren masa të menjëhershme për të standardizuar funksionimin e KVR-ve, për të siguruar mbështetje të qëndrueshme financiare dhe për të integruar të rinjtë në ciklin real të politikëbërjes, ekziston rreziku që të thellohet humbja e besimit të brezit të ri ndaj institucioneve. Një cenim i tillë nuk ndikon vetëm te përfaqësimi rinor, por prek në mënyrë të drejtpërdrejtë legjitimitetin e vetë institucioneve demokratike.

Një tjetër arsye e rëndësishme që e bën këtë periudhë kaq kritike është procesi i integritetit evropian, i cili e vendos pjesëmarrjen qytetare, përfshirë atë rinore, në qendër të reformave shtetërore. Kapitujt 23 dhe 24 të *acquis communautaire* kërkojnë standarde të larta të përfshirjes, transparencës dhe llogaridhënies. Në këtë kontekst, strukturat rinore nuk janë vetëm një çështje e brendshme rinore, ato janë një tregues konkret i gatishmërisë institucionale dhe politike për të përmbushur kriteret evropiane.

Paralelisht, Shqipëria ndodhet në një moment politik dhe institucional të veçantë: krijimi i Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, angazhimi i shtuar i Agjencisë Kombëtare për Rininë, përfaqësojnë hapa realë drejt rritjes së profilit të politikave rinore në agjendën kombëtare. Këto institucione janë tashmë të angazhuara jo vetëm në mbështetjen e organizatave rinore përmes granteve dhe burimeve, por edhe në procesin e hapjes dhe fuqizimit të qendrave rinore, të cilat mund të luajnë rol kyç në ndërtimin e një kulture pjesëmarrjeje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Në këtë klimë të re, ku rinia po vendoset në fokusin e politikave zhvillimore kombëtare dhe ndërkombëtare, mosveprimi institucional përforcon pasivitetin dhe apatinë. Përkundrazi, ky është momentum-i i duhur për të ndërtuar një kulturë të re politike ku të rinjtë jo vetëm të dëgjohen, por të përfshihen si bashkëkrijues të politikave që i prekin. Veprimi i koordinuar ndërinstitutional në këtë fazë nuk është vetëm një detyrim ligjor, është një investim politik për të ardhmen demokratike të vendit..

5. REKOMANDIME PËR AKTIVIZIMIN DHE QËNDRUESHMËRINË E STRUKTURAVE RINORE NË SHQIPËRI

Për të përmbushur në mënyrë të plotë objektivat e Ligjit për Rininë dhe për të bërë realitet pjesëmarrjen kuptimplotë të të rinjve në jetën publike dhe politikëbërje, është e nevojshme një qasje strategjike që kalon nga përmbushja formale e detyrimeve ligjore në funksionalizim të mirëfilltë të mekanizmave rinorë. Më poshtë paraqiten rekomandime kyçe, të strukturuar sipas fushave të ndërhyrjes:

4.1 Standardizimi i përbërjes dhe funksionimit të strukturave rinore

Është e domosdoshme që AKR dhe Ministria e Shtetit për Rininë dhe fëmijët të zhvillojnë një udhëzues kombëtar operacional për strukturat rinore, i cili të përfshijë kriteret e qarta për përzgjedhjen e anëtarëve të KVR-ve, mandatin e tyre, strukturën organizative dhe mënyrën e funksionimit. Kjo do të sigurojë një standard të përbashkët në të gjithë vendin dhe do të reduktojë praktikën e paqëndrueshme që aktualisht ndryshojnë nga një bashki në tjetrën. Udhëzuesi duhet të jetë praktik, fleksibël dhe i përshtatshëm me realitetet lokale, por me një bërthamë të unifikuar që garanton përfaqësim të drejtë, gjithëpërfshirës dhe transparent.

4.2 Forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe institucionale

Strukturat rinore duhet të mbështeten përmes një programi kombëtar të trajnimit, të zhvilluar në partneritet me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet akademike. Ky program duhet të fokusohet jo vetëm në aftësitë organizative dhe menaxheriale të KVR-ve dhe koordinatorëve të rinisë, por edhe në zhvillimin e kompetencave qytetare, si avokimi, monitorimi i politikave dhe pjesëmarrja buxhetore. Paralele me këtë, bashkitë duhet të emërojnë staf specifik me mandat dhe rol të qartë, të cilët të shërbejnë si urë lidhëse midis strukturave rinore dhe administratës vendore.

4.3 Buxhetim dhe mbështetje logjistike të qëndrueshme

Çdo bashki duhet të planifikojë një buxhet të dedikuar për rininë, i cili të përfshijë një linjë specifike për funksionimin e KVR-ve. Kjo mbështetje duhet të mbulojë nevojat bazë si: hapësira për mbledhje, materiale, shpenzime për aktivitete, dhe trajnim. Përtej mbështetjes financiare, është e rëndësishme të krijohet një model i qëndrueshëm që nxit edhe bashkëfinancimin përmes projekteve me OSHC-të, për të përfshirë burime shtesë dhe për të nxitur partneritete strategjike.

4.4 Krijimi i mekanizmave të matjes dhe llogaridhënies

Funksionaliteti i strukturave rinore nuk mund të vlerësohet pa indikatorë të matshëm performance dhe një sistem të standardizuar raportimi. AKR në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse dhe rrjetet rinore duhet të zhvillojnë një kornizë të matjes së impaktit të KVR-ve, përfshirë: pjesëmarrjen në vendimarrje, angazhimin në proceset e politikëbërjes, aktivitete të organizuara, dhe perceptimin e të rinjve në komunitet për funksionimin e këtyre strukturave. Çdo KVR duhet të raportojë vjet në mënyrë publike dhe transparente, duke krijuar baza të qarta për përmirësim të vazhdueshëm.

4.5 Edukimi qytetar dhe përfshirja e sistemit arsimor

Shkollat dhe institucionet arsimore duhet të bëhen pjesë e qasjes për rritjen e pjesëmarrjes rinore. Rekomandohet hartimi i një memorandumit ndër-institucional midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe fëmijët për të lehtësuar aksesin e strukturave rinore dhe OSHC-ve në shkolla. Kjo do të mundësonte ndërveprimin me të rinjtë që nuk janë ende të aktivizuar dhe do të ndihmonte në ndërtimin e një kulture të hershme të pjesëmarrjes qytetare.

4.6 Përforsimi i rolit të AKR-së si koordinator dhe mbështetës teknik

Agjencia Kombëtare për Rininë ka një rol unik si institucion ndërmjetësues mes qeverisjes qendrore dhe realitetit të pjesëmarrjes në terren. Për të përmbushur këtë rol, AKR duhet të pajiset me më shumë kapacitete teknike dhe burime për të ofruar mbështetje të drejtpërdrejtë për strukturat rinore lokale, për të zhvilluar mekanizma vlerësimi, për të përhapur praktikat më të mira, dhe për të monitoruar zbatimin e politikave rinore në mënyrë gjithëpërfshirëse. Rrjetëzimi i strukturave rinore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar është një tjetër funksion që AKR mund ta zhvillojë më tej, për të rritur zërin e të rinjve në nivel rajonal dhe evropian.

ZËRI NGA STRUKTURAT RINORE LOKALE: Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen.

Për të kuptuar më mirë sfidat që hasin strukturat rinore në funksionimin e përditshëm të tyre, si dhe për të mbledhur sugjerime konkrete për përmirësim, në fillim të këtij procesi u zhvillua një pyetësor i shkurtër me koordinatorët e Këshillave Rinore Vendorë në katër bashki: Shkodër, Has, Malësi e Madhe dhe Sarandë. Pyetësi synonte të ofronte një pasqyrë të funksionimit aktual të këtyre strukturave, duke ndihmuar në identifikimin e fushave ku nevojitet më shumë mbështetje dhe zhvillim.

Nga përgjigjet e mbledhura dolën disa çështje të rëndësishme, të cilat përbëjnë mundësi konkrete për zhvillim dhe forcim të mëtejshëm të këtyre strukturave:

Qartësia e rolit dhe funksioneve: Në disa raste u evidentua mungesa e udhëzimeve të detajuara mbi përgjegjësitë dhe misionin e KVR-ve, si dhe lidhja jo gjithmonë e qartë me strukturat e bashkisë.

Nevoja për trajnime dhe mbështetje: Koordinatorët theksuan rëndësinë e rritjes së kapaciteteve të anëtarëve, përfshirë formimin në avokim, komunikim me publikun dhe menaxhimin e nismave rinore.

Përfaqësimi dhe gjithëpërfshirja: U theksua rëndësia e proceseve të qarta, transparente dhe gjithëpërfshirëse për përzgjedhjen e anëtarëve, në mënyrë që KVR-të të pasqyrojnë sa më mirë larminë e të rinjve në komunitet.

Mbështetja financiare dhe logjistike: Mungesa e burimeve dhe infrastrukturës për zhvillimin e aktiviteteve rinore u përmend si një pengesë për realizimin e ideve dhe pjesëmarrjes aktive.

Bashkëpunimi institucional dhe autonomi më e madhe: Këshillat shprehën nevojën për struktura më të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet vendore, si dhe më shumë hapësirë për të planifikuar dhe zbatuar nisma në mënyrë të pavarur.

Këto gjetje përputhen në mënyrë domethënëse me rezultatet e projektit “Zë dhe Impakt-fuqizimi i këshillave rinor për ndrrshimin e komunitetit”, i cili po zbatohet nga organizata Përtej Barrierave në katër bashki: Maliq, Sarandë, Tepelenë dhe Gjirokastrë. Projekti mbështetet nga Fondacioni i Qendrës për Demokraci dhe zhvillohet në kuadër të programit RYDE- Regional Youth Dialogue for Europe, i financuar nga Bashkimi Evropian. Ky projekt synon fuqizimin e demokracisë pjesëmarrëse në nivel lokal përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë të Këshillave Rinorë.

Në kuadër të tij janë përfshirë 41 anëtarë të KVR-ve, të cilët kanë marrë pjesë në trajnime për leadership, avokim dhe analiza politike; janë realizuar takime individuale dhe punëtori me të rinjtë, për të identifikuar nevojat dhe prioritetet e komunitetit; janë hartuar 4 Plane Lokale të Veprimit Rinor, në bashkëpunim me bashkitë dhe me ndihmën e ekspertëve dhe janë organizuar forume publike dhe fushata avokimi, që kanë mundësuar dialog të drejtpërdrejtë ndërmjet të rinjve dhe institucioneve vendore.

Gjetjet e këtij projekti mbështesin dhe përforcojnë vlerësimet e nxjerra nga pyetësi i zhvilluar me koordinatorët e Këshillave Rinore, duke treguar një përputhje të qartë jo vetëm në perceptimet dhe nevojat e të rinjve, por edhe në ato që dolën gjatë konsultimeve të drejtpërdrejta me Këshillat Rinore Vendorë dhe përfaqësuesit e bashkive në kuadër të projektit ‘Zë dhe Impakt’. Kjo konsistencë ndërmjet gjetjeve nga terreni dhe proceseve të organizuara në kuadër të projektit tregon se puna për forcimin e strukturave rinore ka nisur dhe është në rrugë të mirë. Megjithatë, për të garantuar qëndrueshmëri dhe ndikim afatgjatë, nevojitet vazhdueshmëri për proceset e përmirësimit, bashkëpunim i ngushtë institucional dhe angazhim i përbashkët midis të rinjve dhe autoriteteve vendore.

Këto perspektiva nga terreni përforcojnë analizën e bërë në këtë dokument dhe i japin legjitimitet rekomandimeve të propozuara. Të rinjtë nuk kërkojnë vetëm të jenë pjesë simbolike e vendimmarrjes, ata kërkojnë struktura që funksionojnë, që i dëgjojnë dhe që i mbështesin në mënyrë reale dhe të qëndrueshme.

6. PËRMBYLLJE: STRUKTURAT RINORE SI BAZË PËR PJESËMARRJE DEMOKRATIKE DHE LEGJITIMITET POLITIK

Rruga drejt një demokracie funksionale dhe gjithëpërfshirëse kalon përmes përfshirjes reale të të rinjve në politikëbërje. Në Shqipëri, është bërë progres i konsiderueshëm në aspektin normativ dhe institucional: ekziston një ligj modern për rininë, janë ngritur struktura përfaqësuese në nivel vendor dhe kombëtar, dhe është ndërtuar një kuadër strategjik që i njeh të rinjtë si aktorë të rëndësishëm të shoqërisë. Por kjo arkitekturë do të mbetet formale nëse nuk shoqërohet me funksionalitet real, ndikim politik dhe legjitimitet përfaqësues.

Pjesëmarrja e të rinjve nuk është vetëm një kërkesë sociale apo edukative, është një çështje thelbësore politike. Ajo është pjesë e indikatorëve që matin shëndetin e demokracisë në nivel lokal dhe kombëtar. Siç e dëshmon edhe Indeksi i Pjesëmarrjes Rinore 2023, pjesëmarrja e të rinjve në institucione vendimmarrëse dhe pozicione drejtuese është në nivelin më të ulët krahasuar me indikatorët e tjerë. Të rinjtë janë të pranishëm në strukturat rinore, por shumë pak të përfaqësuar në politikën reale. Kjo krijon një boshllëk të rrezikshëm midis përfaqësimit formal dhe ndikimit real, që dëmton besimin e të rinjve në proceset demokratike dhe e dobëson kapacitetin e institucioneve për të reflektuar nevojat e brezit të ri.

Ky dokument synon të ndihmojë në riformatimin e rolit të strukturave rinore nga instrumente të mbyllura dhe të paqarta, në mekanizma të hapur, të funksionalizuar dhe me fuqi ndikimi. Që kjo të ndodhë, kërkohej angazhim i sinqertë politik nga institucionet, por edhe një rifokusim strategjik: pjesëmarrja rinore nuk është vetëm pjesë e agjendës rinore, është pjesë e reformës së vetë demokracisë. Nëse të rinjtë përjashtohen nga përfaqësimi real, demokracia humbet energjinë, mendimin kritik dhe legjitimitetin përfaqësues që vetëm brezat e rinj mund ta sjellin. Prandaj, forcimi i strukturave rinore nuk është një prioritet i sektorit të rinisë, është një prioritet i vetë shtetit, që lidhet me përmbushjen e standardeve evropiane, qëndrueshmërinë e reformave, dhe ruajtjen e besimit të qytetarëve në institucionet demokratike.

Sot, më shumë se kurrë, ka nevojë për hapa konkretë që i japin kuptim pjesëmarrjes rinore, jo si ideal, por si realitet politik i prekshëm dhe i matur.



Për më shumë detaje rreth projektit, vizitoni:



youthwbt.eu

Ky botim është financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e organizatës Beyond Barriers dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.